



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:726/25 Datë:20.06.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 138 të mbajtur më 16.06.2025, mori:

V E N D I M

I. **Aprovohet** kërkesa e Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë Nr.603/25 datë 30.05.2025 për validim të ri/akreditimit institucional dhe të programeve:

1. Validohet **Akreditimi Institucional** për periudhën **pesë (5) vjeçare** (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030).
2. Validohet Akreditimi i programit **Administratë Publike BA** për periudhë **tre (3) vjeçare** (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), me kuotën **60 studentë** për vit akademik.
3. Validohet Akreditimi i programit **Menaxhim Biznesi BA** për periudhën **pesë (5) vjeçare** (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030), me kuotën **100 studentë** për vit akademik.
4. Validohet Akreditimi i programit **Menaxhim i Mjedisit dhe Teknologji BSc** për periudhën **pesë (5) vjeçare** (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030), me kuotën **60 studentë** për vit akademik.
5. Validohet Akreditimi i programit **Menaxhim Ndërkombëtar dhe Qëndrueshmëri MSc** për periudhën **pesë (5) vjeçare** me kuotën **90 studentë** për vit akademik, me specializimet:
 - Menaxhimi i Biznesit;
 - Menaxhimi i Mjedisit;
 - Menaxhim Social.
6. Zgjatet për **një (1) vit akademik** Validimi i programit **Teknologji dhe Informatike e Aplikuar Bachelor Profesional**, (1 tetor 2025 - 30 shtator 2026).

- II. Obligohet Kolegji Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë të raportojë dhe arsyetojë në AKA çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- III. Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi dhe vendimeve relevante për validim institucional dhe të programeve.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji IBCM, me datë 30.05.2025 ka paraqitur kërkesë Nr.603/25 për validimin e akreditimit Institucional dhe të programeve sipas raporteve të lëshuara nga vlerësuesi i jashtëm Evalag — Evaluation Agency Baden-Württemberg, në përputhje me aplikimet për akreditim që janë miratuar më parë nga KShC.

1. Akreditimi Institucional: Evalag i ka dhënë IBCM-së akreditim institucional gjashtë-vjeçar, i vlefshëm deri më 30 shtator 2031.
2. Akreditimi i Programeve: Evalag ka dhënë gjithashtu akreditim gjashtë-vjeçar, i vlefshëm deri më 30 shtator 2031, për programet në vijim:
 - Administratë Publike, Bachelor i Arteve;
 - Menaxhim i Biznesit, Bachelor i Arteve;
 - Menaxhim i Mjedisit dhe Teknologji, Bachelor i Shkencës;
 - Menaxhim Ndërkombëtar dhe Qëndrueshmëri, Master i Shkencës.
3. Sipas kërkesës së IBCM, citojmë *“Shtimi i vitit të fundit të akreditimit për Teknologji dhe Informatikë e Aplikuar (Bachelor Profesional). Programi Teknologji dhe Informatikë e Aplikuar, Bachelor Profesional u akreditua nga Evalag në vitin 2020 për një periudhë gjashtë-vjeçare (e vlefshme deri më 31 tetor 2026). Vendimi juaj i validimit (nr. 2749/20) mbuloi vetëm pesë vitet e para, duke skaduar në vitin 2025. Kërkojmë, pra, shtimin e vendimit për të zgjatur validimin deri në fund të vlefshmërisë së akreditimit të lëshuar nga Evalag-u (2025-2026), në mënyrë që riakreditimi i radhës, që do ta paraqesim këtë vit, të mos ndërpritet.”*

IBCM si dëshmi ka bashkëngjitur edhe certifikatat e akreditimit dhe raportet e ekspertëve për të gjitha procedurat e përmendura më sipër.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 138 të mbajtur më datë 16.06.2025, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin relevant të Kolegjit IBCM.

Në të gjitha rastet kur ri/akreditimi nga Evalag ishte rekomanduar për gjashtë (6) vite validimi nga KShC bëhet për periudhën 5 vjeçare, pra 1 vit më pak se sa akreditimi nga Evalag, është bërë duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, përkatësisht me nenin 35, paragrafin 2. "*Kohëzgjatja e riakreditimit të programit është tre (3) ose pesë (5) vjet*".

KShC ka marr parasysh vlerësimin e Evalag-ut dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe kompetencat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit IBCM;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.